

Datë 31.03.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

KARBURANT 2 lote

Karburant

Loti I Naftë benzinë

Loti II Naftë për kaldajë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Naftë 09134000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **26.846.375,23 (njëzetë e gjashtë milion e tetëqind e dyzetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë presje njëzetë e tre) leke pa t.v.sh ose 279,533.27 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre presje njëzetë e shtatë) euro sipas kursit të këmbimit valutor datë 17.03.2026 i cili është 96.04 lekë**

Loti I Naftë benzinë 21,862,317.44 (njëzetë e një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë presje dyzetë e katër) lekë pa tvsh ose 227,637.62 (dyqind e njëzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e dy) euro sipas kursit të këmbimit valutor datë 17.03.2026 i cili është 96.04 lekë

Loti II Naftë për kaldajë 4,984,057.79 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh 51,895. 65 (pesëdhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e pesë) euro sipas kursit të këmbimit valutor datë 17.03.2026 i cili është 96.04 lekë

6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes:

Në zbatim të nenit 52/1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 64 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, përcaktohet se: *“Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”*

3. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës.

Sipas Udhezimit nr 6 date 16.01.2018 I ndryshuar **pika 3** citohet se:

Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave,

Pika 3.2 citohet se:

Një autoritet kontraktor për zgjedh realizimin e një marrëveshje kuadër, kur në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit:

a) ka nevojë për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose;

b) është e pamundur të përcaktohet objektivisht sasia/sasinë e objektit të prokurimit ose elementëve të tij dhe/ose;

c) është e pamundur të përcaktohet objektivisht data e saktë e dorëzimit të mallit, punës, shërbimit ose pjesëve të tyre dhe/ose;

ç) është e pamundur të përcaktohet objektivisht vendi i saktë i lëvrimit të mallit, punës, shërbimit, ose pjesëve të tyre dhe/ose;

d) është e pamundur të përcaktohen një ose disa kushte të tjera që ndikojnë në realizimin e objektit të prokurimit dhe/ose;

dh) çmimet e tregut janë të paqëndrueshme dhe për arsye teknike dhe teknologjike, objekti i kontratës (malli, puna, shërbimi) mund të dorëzohet nga disa operatorë ekonomikë të suksesshëm, gjë që e bën rihapjen e konkurimit më efektive për shkak të reduktimit të çmimit, sesa fillimin e një procedure të re prokurimi.

PIKA 9 citohet se:

Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen

ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Në bazë të Ligjit nr 8450 datë 24.02.199 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , gazit dhe nënprodukteve të tyre ” i ndryshuar Neni 15 pika 4 citohet se:
“ *Stacioneve të shitjes se karburanteve u ndalohet të tregtojnë karburante për mjete transporti, detar e ajror, si dhe lende djegëse të lëngëta apo të gazta.*”

Në kuptim të dispozitës së mësipërme ku përcakton se stacionet e shitjes së karburantit për automjete i ndalohet të tregëtojnë lëndë djegëse për përdorim ngrohje i jep të drejtën autoritetit ekonomik të ndajë procedurën në dy lotë për të nxitur konkurrencën si dhe duke marrë në konsideratë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gjirokastrë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Formulari i ofertës të përfshijë element si më poshtë:

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date⁴⁷;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës⁴⁸

.
APP publikon çmimet e bursës së dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant (Diesel dhe Benzinë pa plumb), vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburat gazoil ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë Autoritetet/Entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të

publikuar në Buletinin e njoftimeve publike i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF- Shqipëri, në këtë moment

PËR LOTIN I NAFTAË / BENZINË

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023 2024 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, , në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023 2024 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

1. Operatori ekonomik duhet të disponojë, jo më pak se 1 (nje) "stacione të shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante" të pajisur me licencën përkatëse, në të cilin të tregtohet normalisht karburantet e llojeve, **Diesel Gazoilit** (10 ppm ULSD) dhe **BENZINE** (PREMIUM UNL 10 ppm) në një distancë jomë të largët se 12 km nga qyteti i Gjirokastrës të vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronarie ose kontrate noteriale qeraje, me afat të pakten deri me **12 muaj nga data e hapjes dhe vlerësimit të ofertave** ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB).

Argumentim

Bashkia Gjirokastrë ka 6 Njësi Administrative në gjithë territorin e saj dhe si rrjedhojë mjetet të cilat janë në funksion të të gjithë territorit vlen të jetë e nevojshme për të pasur 2 pika furnizimi me karburant pasi vetëm një pikë furnizimi nuk do të ishte e nevojshme sepse një mjet fadrome i duhet të bëjë disa km më shumë dhe norma e harxhimit do të jetë më e lartë për vajtje ardhje në një distancë të largët ndërsa nëse do të jetë një pikë furnizimi më afër njësitve atëherë norma e harxhimit për rrugën e përshkruar do të jetë më e vogël se sa ajo në rast se do të ishte vetëm një pikë dhe ndërkohë normën e harxhimit të cilën e reduktojmë nga ky fakt kemi mundësi për ta shfrytëzuar në mënyrë produktive për një punë të caktuar.

2. **Ky stacion** të jenë të pajisura me Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit dhe Policë Sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve shoqerore që operojnë në Shqipëri për distributorët e shitjes me pakicë dhe të jetë brenda vlefshmërisë së datës së hapjes së ofertave.

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 " Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar

KREU IV KONTROLLI MBI PERSONAT JURIDIKE, QË USHTROJNE VEPRIMTARI TË PERPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TË TYRE

Neni 22

Shteti organizon dhe ushtron kontroll në personat juridike që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Drejtimet kryesore të këtij kontrolli janë :

- Respektimi i normave teknike dhe i masave të mbrojtjes nga zjarri në instalimet, impiantet dhe pajisje që përdoren nga persona juridike;

Urdhërit Nr 315 datë 24.8.2017” Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit , transportimit dhe tregimit të naftës dhe nënprodukteve të saj ”

- 3. Cdo operator ekonomik duhet që të sjellë, flete analizat për karburantin e kërkuar, Diesel Gazoilit(10 ppm ULSD) BENZINE(PREMIUM UNL 10 ppm) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik, dhe Industrial , Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit (laboratori i kontrollit të naftës dhe gazit) . **Fletë analiza duhet të jetë lëshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes së ofertave .****

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar

Neni 23

Inspektorati Shtetëror Përgjegjës

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ky inspektorat mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektorati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës.”.

2.a) Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për:

i) kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ii) miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse; iii) kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit nga data e hapjes së ofertave për të gjitha stacionet që disponon referuar QKB

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar neni 23

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin

Për realizimin e këtyre detyrave Inspektorati Shtetëror Përgjegjes bashkëpunon me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore, që mbulojnë fushën e ndërtimit, të rendit publik, të veprimtarisë tregtare, të mbrojtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit.

5. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakisë në shërbim 24 orë sipas nevojave të qe ka Autoriteti Kontraktor.
6. Specifikime teknike të lëndës djegëse Diezel duhet të jenë sipas standartit shqiptar SSH EN 590 2022 dhe për lëndën djegëse Benzinë duhet të jetë sipas standartit t SSH EN 228 :2018 / SSH EN 228:2012 + A1: 2017

Argumentim

Akt normativ nr 8 datë 25.03.2022 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar neni 21/5

7. Operatori duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 ” Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente
8. Operatori duhet të disponojë certifikate ISO 14001:2015” Për sistemin e menaxhimit të mjedisit ” ose ekuivalente

Argumentimi:

Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të ofertojë vetëm më një vlerë absolute për te dyja lëndet djegëse dhe me një vlerë totale oferte . Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas dispozitës ligjore Neni 45 pika 2.1 e Vkm nr 285 datë 19.05.2026 ” Për rregullat e prokurimit publik ” i ndryshuar Gjithashtu operatori ekonomik duhet ti përmbahet Vendimit të Bordit nr 02 datë 28.03.2026 “ Për miratimin e cmimit tavan të tregëtimit me shumicë / pakicë të nënprodukteve të naftës dhe gazit ” ose të një njoftimi në vijim, të rradhës.

10. Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistolette publike.

11. Operatori/et Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Autorizim për tregëtim me pakicë të karburanteve , gazit të lëngshëm të naftës për automjetet , vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë të lëshuar nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore .

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar

Neni 20

Autorizimet

1. Autorizimet u jepen personave juridike, të parashikuar në pikat "ç" dhe "d", të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lendeve djegëse (njësitë e shitjes së lendeve djegëse).

2. Autorizimet për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuar në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Autorizimet për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënie të autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

12. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të të cilës duhet të garantojë, se do të realizojë furnizimin e sasive përkatëse të karburantit nëpërmjet kartave

elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoriteteteve Kontraktore që bashkëshoqërohen edhe me kuponin tatimor të lëshuar për çdo furnizim, që i vendoset në dispozicion Autoritetit Kontraktor me një sistem "on-line". Mosplotësimi i këtij kriteri përbën shkak për skualifikim.

Argumentim

VKM nr 561 date 29.07.2016 "Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme" dhe ne Njoftimin nr 2123 date 31.01.2017 te APP

13. Përsa me sipër për të gjitha shërbimet e sipërcituara operatori duhet të deklarojë se disponon një faqe ëeb të menaxhimit të karburantit (ëebpage) ku për cdo furnizim të kryer të mjetit shërbimet e sipërcituaratë të jenë të deklaruara në të dhe AK të njoftohet me anë të email-it zyrtar për cdo furnizim të mjetëve kjo për të evituar lëvizjen e mundshme të furnizimit me karburant nga mjetet me targa shtetërore drejt atyre private. Ndërkohë faqia duhet të ofrojë dhe mundësinë e afishimit si dhe administrimit të sasisë së karburantit të kryer nga vet Autoriteti Kontraktor. Mosdisponimi i këtij shërbimi ëeb përbën shkak për skualifikim.

Argumentim

VKM nr 561 date 29.07.2016 "Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme" dhe ne Njoftimin nr 2123 date 31.01.2017 te APP

14. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë Regjistrimi Marke të leshuar nga Ministri e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 " Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar Neni 15 pika 10

10. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të shkruajnë emra artikujsh të ndryshëm nga ata që shesin realisht dhe të vendosura sipas standardeve të parashikuara në legjislacion në fuqi. Këto stacione duhet të vërtetojnë me dokumentacion përkatës që produkti apo shërbimi që ofrojnë i përket markës dhe standardit që reklamojnë.

Ligji Nr 9947 datë 07.07.2008 " Për ponësinë industriale " i ndryshuar Neni 154

Regjistrimi i markës (Ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. DPPM-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit 3-mujor nga data e publikimit të markës, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar. Aplikuesi paguan tarifën e regjistrimit brenda një muaji nga data e njoftimit nga DPPM-ja. DPPM-ja regjistron markën në regjistrin e markave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda tre muajve nga kryerja e pagesës nga aplikuesi.

2. DPPM-ja refuzon aplikimin nëse aplikuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Marka e regjistruar publikohet në buletinin e DPPM-së.

4. Të dhënat për certifikatën e regjistrimit dhe për publikimin e markës parashikohen në rregulloren përkatëse.

Sasia e karburantit do të lëvrohet nga kontraktuesi nëpërmjet kartave elektronike për cdo mjet të dhënat për mjetet do të jepen kontraktorit në momentin e lidhjes së kontratës.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike, për realizimin e të gjitha loteve për të cilat ka ofertuar.

Operatorët ekonomik duhet të ofertojnë me vlerë absolute dhe me një vlerë totale oferte për secilin lot

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në rastin e Operatorëve ekonomik të huaj i gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “ Apostile ”.

Për vendet që kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 05.10.1961 për “ Heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik konsullor të dokumentave zyrtarë të huaj ” dokumentat e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me Ligjin nr 9060 datë 08.5.2003 “ Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtarë të huaja”

Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 05.10.1961 për “ Heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik konsullor të dokumentave zyrtarë të huaj ” duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat , konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues

PËR LOTIN II NAFTË PËR KALDAJË

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023 2024 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023 2024 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të këtij loti**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - c) **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se .20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.
1. Operatori ofertues duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi Gazoil me e vogël se 0.1%, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, raport analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar

Neni 23

Inspektorati Shtetëror Përgjegjës

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ky inspektorat mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektorati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës.”

2.a) Inspektorati shtetëror përgjegjës ka të drejtë dhe përgjigjet për:

- i) kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e këtij ligji;***
- ii) miratimin e kartave teknologjike të impianteve dhe instalimeve përkatëse;***

iii) kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë edhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit;

2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin e fundit nga data e hapjes së ofertave për të gjitha stacionet që disponon referuar QKB

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar neni 23

Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin

Për realizimin e këtyre detyrave Inspektorati Shtetëror Përgjegjes bashkëpunon me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore, që mbulojnë fushën e ndërtimit, të rendit publik, të veprimtarisë tregtare, të mbrojtjes nga zjarri dhe të ruajtjes së mjedisit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë me shkrim se merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant dhe me automjetet e tij.
4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatë Regjistrimi Marke të lëshuar nga Ministri e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar Neni 15 pika 10

10. Stacioneve të shitjes së karburanteve u ndalohet të shkruajnë emra artikujsh të ndryshëm nga ata që shesin realisht dhe të vendosura sipas standardeve të parashikuara në legjislacion në fuqi. Këto stacione duhet të vërtetojnë me dokumentacion përkatës që produkti apo shërbimi që ofrojnë i përket markës dhe standardit që reklamojnë.

Ligji Nr 9947 datë 07.07.2008 “ Për ponësinë industriale ” i ndryshuar Neni 154 Regjistrimi i markës (Ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. DPPM-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit 3-mujor nga data e publikimit të markës, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar. Aplikuesi paguan tarifën e regjistrimit brenda një muaji nga data e njoftimit nga DPPM-ja. DPPM-ja regjistron markën në regjistrin e markave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda tre muajve nga kryerja e pagesës nga aplikuesi.
2. DPPM-ja refuzon aplikimin nëse aplikuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Marka e regjistruar publikohet në buletinin e DPPM-së.
4. Të dhënat për certifikatën e regjistrimit dhe për publikimin e markës parashikohen në rregulloren përkatëse.

5. Operatori/et Ekonomik duhet detyrimisht të jetë i pajisur me Licencë me kod VIII.1.A dhe kategoria III/A të leshuar nga *Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)* me afat vlefshmërie për të gjithë periudhën e kësaj procedure

Argumentim

Në përputhje me Ligjin Nr 8450 datë 24.02.1999 “ Për përpunimin , transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar Neni 4

Veprimtaritë e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori. Në rastin e dytë, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje.

Neni 10

Në kuptim të këtij ligji, nafta, gazi natyror dhe nënproduktet e tyre klasifikohen në kategori, si vijon:

Kategoria O

A. Nafta bruto

B. Gazi natyror

Kategoria I

A. Gazi i lëngshëm

Kategoria II

A. Benzine automjetesh

B. Benzine mjetesh të fluturimit ajror

C. Nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, ëhite spirit.

Kategoria III

A. Gazoil (Diezel)

B. Vajguri ndriçues

C. Lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)

Ç. Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial

Neni 20

Licencat

1. Licencat u jepen personave juridike, të parashikuar në pikat "ç" dhe "d", të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftes dhe vajrave lubrifikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lendeve djegëse (njësitë e shitjes së lendeve djegëse).

2. Licencat për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuar në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Licencat për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Në bazë të Vkm nr 970 datë 02.12.2015 " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj " pika 1

1. Veprimtaria e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregtare, të themeluara në formën e shoqërive aksionare, pasi të jenë pajisur me "Licencë tregtimi" nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë Leje Mjedisore e tipit B sipas legjislacionit mjedisor Për ndikimin në mjedis

Argumentim

Në bazë të ligjit 10448 datë 14.07.2011 " Për lejet e mjedisit " I ndryshuar

Në bazë të Vkm nr 419 datë 25.06.2014 " Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A B dhe C për transferimin e lejeve nga një subject në tjetër , të kushteve për lejet respective të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja "

7. Subjekti të ketë në dispozicion në pronësi ose me qera një autobot për transport gazoili, I cili të jetë 500 - 1500 lt peshë mbajtëse për arsye të lëvizjes lirshëm nëpër ambientet e Autoritetit Kontraktor në cdo kohë pas njoftimit 24 orë përpara nga ana e AK për

furnizimin e rradhës. DUHET të paraqitet i gjithë dokumentacion ligjor i nevojshëm (certifikatë pronësie, certifikatë inspektimi të cisternes, pasaporta e botit, certifikatën e transportit "Lëndë e Rrezikshme" lëshuar nga autoriteti përkatës, leje qarkullimi, policë sigurimi, kontrolli teknik vjetor, taksat vjetore, akt teknik lëshuar nga PMNZSH për mjetin, ADR e mjetit shoqëruar me Leje Drejtimi ADR të shoferit) Brenda afateve ligjore për të bërë furnizimin sipas kërkesave të AK

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ofertojë me një vlerë absolute dhe me një vlerë totale oferte. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ofertojë sipas dispozitës ligjore Neni 45 pika 2.1 e Vkm nr 285 datë 19.05.2026 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar Gjithashtu operatori ekonomik duhet të përmbahet Vendimit të Bordit nr 02 datë 28.03.2026 "Për miratimin e cmimit tavan të tregëtimit me shumicë / pakicë të nënprodukteve të naftës dhe gazit" ose të një njoftimi në vijim, të rradhës

Kaldajave të institucioneve në arsimin parauniversitar
Shkollat:

"Asim Zeneli" fshat
"Siri Shaplo" ne lagjen "18-Shtatori",
"Pandeli Sotiri", në lagje "11-Janari"
"Feim Ibrahim", në lagjen "Varosh"
"Urani Rumbo" ne lagjen "Palorto",
"Koto Hoxhi", në lagje "18-Shtatori",
"Andon Zako Çajupi", në lagjen "Pllakë",
"Muhamet Gjollësja" Lazarat,
"Naim Frasheri", në lagjen "Dunavat";
"Petro Poga" Lunxhëri

Institucionet në arsimin parauniversitar
Kopshti nr. 4/5/7,

9. Operatori duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalente
10. Operatori duhet të disponojë certifikate ISO 14001:2015" Për sistemin e menaxhimit të mjedisit " ose ekuivalente

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike, për realizimin e të gjitha loteve për të cilat ka ofertuar.

Argumentimi:

Kerkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat

ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike, për realizimin e të gjitha loteve për të cilat ka ofertuar.

Në rastin e Operatorëve ekonomik të huaj i gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “ Apostile ”.

Për vendet që kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 05.10.1961 për “ Heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik konsullor të dokumentave zyrtarë të huaj ” dokumentat e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me Ligjin nr 9060 datë 08.5.2003 “ Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtarë të huaja”

Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 05.10.1961 për “ Heqjen e kërkesës për legalizimin diplomatik konsullor të dokumentave zyrtarë të huaj ” duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat , konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Anëtare

Person Përgjegjës

Anëtar

Alma Llace

Lorjana Shehu

Alfons Alikaj